

SHOQËRIA TEKNOLOGJIA SHQIPTARE SHPK

NIPTI: M36614006C

**ADRESA: SHKODER SHKODER KAÇE , VAU DEJES SHKODER Z-K NR:2015, NR-
PASURIE:179/16 VOLUMI/3 FAQE/ 190, 4001**

PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE

VEPRIMTARIA E PRERJES SE BLOQEVË TË MERERIT DHE PËRPUNIMI I PLLAKAVE TË MERMERIT

Administrator



DHJETOR 2024

PËRMBAJTJA E LENDËS

HYRJE

A) NJË PËRSHKRIM TË SHKURTËR TË MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI, TË SHOQËRUAR DHE ME IMAZHE TË MARRA JO MË VONË SE 6 MUAJ NGA DATA E APLIKIMIT;

B) INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ;

C) NJË IDENTIFIKIM TË NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË

BIODIVERSITET, UJË, TOKË, AJËR;

Ç) NJË PËRSHKRIM TË SHKURTËR PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, SI DHE PRODHIMIN E MBETJEVE;

D) INFORMACION PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA;

DH) TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS, QË NËNKUPTON

DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË;

E) MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSINË E KTHIMIT TË SIPËRFAQES SË MJEDISIT TË NDIKUAR NË GJENDJEN E MËPARSHME, PËRFSHIRË EDHE TOKËN BUJQËSORE, SI DHE KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN;

Ë) MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS;

F) NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËR-KUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).

Hyrje.

Subjekti “Teknologjia Shqiptare” shpk, është një subjekt i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT M36614006C, themeluar me datë 12.4.2023 dhe regjistruar me datë 14.4.2023, ushtron veprimtarinë në:

-Eksport import ne sektorin e perpunimit aktiv - Import-eksport, dhe perpunim guri,mermeri,graniti, tregtim me shumice e pakice i gurit, mermerit, granitit dhe materialeve te ndertimit, ,tregtim dhe transportimin i materialeve inerte si:

rera,zhavore,gure,çakull,gelqere,granile dhe materiale te ndryshme per ndertim, Prerje blloku mermeri,guri,graniti, tregtim i nenprodukteve te mermerit dhe granitit , Tregtim me pakice dhe shumice i lastrave te mermerit dhe granitit si dhe Import-eksport i tyre sipas kerkeses,ndertime,rikonstruksione,ndertime godina banimi shumekateshe,ndertim vila,pallate, rruge,punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge,punim restaurimi te ndertesave te ndryshme., e qe konsiderohet i pershtatshem per rritjen dhe zhvillimin e metejshem te aktivitetit te shoqerise.cili ushtron

duke u fokusuar kryesisht në prerjen dhe luxidimin e blloqeve të mermerizuar me qëllim prodhimin e pllakave të mermerit.

Për këtë qëllim ka investuar shuma të mëdha finaciare duke ndërtuar fillimisht një objekt në përbërje të cilit janë disa kapanone dhe zyra.

Në këtë objek subjekti sjell blloqe mermeri dhe i pret, i luxidon dhe i pregatit për tregun e brendshëm dhe eksport.

a) një përshkrim të shkurtër të mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, të shoqëruar dhe me imazhe të marra jo më vonë se 6 muaj nga data e aplikimit;

Objekti në të cilin subjekti “Teknologjia Shqiptare” shpk, do të presë dhe do të përpunojë blloqet e mermerit, ndodhet në teritorin e fshatit Kaçe, i cili bën administrativisht është pjesë e Bashkisë Vau Dejës, në Qarkun e Shkodrës.

Teritori i këtij fshati karakterizohet nga zona rurale, ku në pjesë të vogla të saj janë ndërtuar shtëpi të rrethuara me kopshte dhe me toka që përdoren për të mbjellë perime të ndryshme si dhe të lashta. Pjesë të tokave të këtij fshati janë të zëna me pemë frutore, si arra, mollë, ftonj, qershiri deri në pjergulla rushi.

Përsa i takon sipërfaqes ku do të zbatohet projekti i prerjeve dhe luxidimit të blloqeve të mermerit, ajo është një sipërfaqe ku janë ndërtuar repartet sipas proceseve teknologjik, konkretisht:

Reparti teknologjik, i cili është dhe reparti kryesor që ze rreth 25% të gjithë sipërfaqes. Në këtë repartkryhet i gjithë procesi teknologjik, duke filluar nga prerja, rezenimi dhe luçidimi i pllakave të mermerit;

Reparti i magazinimit, ku dhe ky repart ze gati 25% të sipërfaqes së objektit, dhe shërben për magazinimin e pllakave të mermerit të cilat kanë kalur të gjithë procesin teknologjik dhe janë për tu dërguar në treg të brendshëm apo esport;

Reparti i ofiçinës dhe magazinimit të pjesëve të mekanikës dhe materialeve të tjera. Në këtë repart janë të depozituara pjesë të mekanikës dhe ofiçinës dhe materiale të tjera;

Zyrat e subjektit të cilat zenë mbi 20% të sipërfaqes së objekti, të përbëra nga salla kryesore dhe disa zyra të ndara për financë, administratorin, personelin etj si dhe 2 tualete.

Të gjitha ambientet janë të kompletuara me orenditë e nevojshme tavolina, karrike, rafte e orendi të tjera si dhe me kompjuterat për personelin.

Oborri i objektit është i vetmi vend ku takohet pjesa e gjelbëruar, duke filluar nga pemët frutore, mandarinat deri te lulet e pemët dekorative të vendosura në pjesë të ndara të oborrit. Bimësia në oborrin e objektit është nën kujdesin e një specialisti i cili meret vetëm me atë.




Tabela Nr . Sipërfaqja e objektit dhe përbërësve të tij.

Nr	Emërtimi i sipërfaqeve	m ²	sasia
1	Oborri	m ²	3800
2	Reparti teknologjik	m ²	1500
3	Zyrat	m ²	350
4	Magazina	m ²	2400
5	Gjelberuar	m ²	260
6	Te tjera	m ²	2130
7	Totale	m ²	10440

b) informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj;

Projekti zbatohet në një zonë e cila nuk është e ezauruar përse i përket sistemit të ujësjellës kanalizimeve. Fshati furnizohet me ujë nëpërmjet puseve individuale të cilat janë hapur në çdo shtëpi dhe i shërbejnë familjarëve.

Pavarsisht se mundon sistemi i ujësjellës kanalizimeve, zona është mjaft e pasur me ujra nëntokësorë, gjë e cila vërtetohet nga thellësia e puseve të fshatit e cila fillon nga 8 deri 12 ml thellësi dhe takohet uji.

Proçesi i prerjes dhe luçidimit të plakave të mermerit e ka të nevojshme dhe të domosdoshme përdorimin e ujit. Për sigurimin e ujit, subjekti vite më parë ka hapur një pus, me thellësi deri 40 ml, nga i cili siguron ujin e nevojshëm për proçesin teknologjik të prerjes dhe luçidimit.

c) një identifikim të ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë, ajër;

Projekti i prerjeve të blloqeve të mermerit dhe luçidimit të pllakave të mermerit, bëhet një njëambjen ku është ndërtuar e gjitha infrastruktura e nevojshme. Ky projekt nuk ka ndikime negative në mjedis, si të tilla renditen ndikimet negative përse i takon kohës kur është ndërtuar objekti, sepse janë hapur themele, janë ndërtuar kabanone, është shtruar me asfalt dhe me beton sipërfaqet e kabanoneve etj.

Si rezultat i këtyre proçeseve janë hapur gropa dhe janë çvendosur sasira dheu, të cilat më vonë janë shpërndarë në sipërfaqen e objektit në ato vende ku nuk janë bërë ndërtime.

Nga zbatimi i këtij projekti nuk do të ketë ndikime negative në ujë, ajër apo biodiversitet e tokë. Në këtë projekt nuk përdoren kimikate apo reagentë të cilat e ndotin ujin kimikisht, pjesët e grimacave të mermerit të cilat janë rezultat i prerjes së blloqeve, janë grimca të ngurta të cilat nuk treten në ujë.

Uji i cili përdoret në prerje dhe luçidim nuk ndotet kimikisht, por në përbërje të tij ka grimça të imtat të ngurta të mermerit.

Ky ujë me përmbajtje të grimcave të mermerit, grimca të cilat janë rezultat i prerjes së blloqeve, dërgohet me anën e popave në kullën e seperimit, ku deknaton materiali i ngurtë, ndërsa uji riciklohet në proçes.

ç) një përshkrim të shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, si dhe prodhimin e mbetjeve;

Në projektin e prerjes dhe luçidimit të mermerit përdoret ujë i cili shërben për ftofje të telit të diamntuar që shërben për prerjen e blloqeve si dhe në lucidim. Ky ujë nuk shkarkohet në asnjë mjedis apo kanal, por ai pasi ndahet nga materiali i ngurtë, grimcat e mermerit, riciklohet.

Gjithashtu dhe materiali i ngurtë i përbërë nga grimcat e mermerit dërgohet në land fill sipas një marveshje që ka bërë subjekti me strukturat e vendore.

Përfundimisht nga ky projekt nuk ka sjarkime të mundhme në mjedis si ujra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, si dhe prodhimin e mbetjeve.

d) informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;

ndikimet e evidentuar janë ndikime të cilat do të zgjasin aq kohë sa do të jetë koha e zbatimit të projekti. Në ndikime negative bëjnë pjesë ndikimet në sipërfaqen e tokës dhe në pejsazh.

dh) të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;

Shtrirja e mundshme hapësinore e ndikimeve negative, ndonse janë ndikime që nuk janë aktive nuk i kalon kufijtë rrethues të objektit.

e) mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të sipërfaqes së mjedisit të ndikuar në gjendjen e mëparshme, përfshirë edhe tokën bujqësore, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;

Sipërfaqja në të cilin është ndërtuar objekti ku shoqëria “Teknologjia Shqiptare” shpk, bën prerjen e blloqeve të mermerit dhe luçidimin e pllakave të mermerit, fillimisht ka qenë një truall, i mbuluar me bimësi të ulët, si bar, shkurre të ulta etj.

Një pjesë e saj ka qenë e mbuluar me pemë frutore, të cilat kanë qenë të shpërndara në mënyrë sporadike.

E gjithë sipërfaqja e objektit nga truall u shëndrua në një sipërfaqe ku u ndërtuan repartet për zhvillimin e operacioneve teknologjik, dhe pjesa tjetër u shtrua me çimento për të siguruar ambjente të përshtatshme për lëvizjen e mjeteve të transportit në prurjen e blloqeve të mermerit si dhe në dërgimin e pllakave të mermerit për tregun e brendshëm apo eksport.

Në sipërfaqen e objektit një pjesë e konsiderueshme e saj nuk u prek dhe aty rriten lule të zonës si dhe pemë frutore, amndarina e protokolale etj.

Për rehabilitimin e kësaj sipërfaqeje subjekti “Teknologjia Shqiptare” shpk, ka investuar shuma financiare deri në disa milion lekë, duke filluar nga ndëtimet, sistemimet, shtrimine rrugëve të brendshme deri në mirmbajtjeje bimësisë, luleve apo drurëve frutorë.

Vlen për tu theksuar se shoqëria “Teknologjia Shqiptare” shpk, e ka në qendër të vemëndjes ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit brënda teritorit të objektit dhe rreth tij, veçanërisht në mirmbajtjen dhe shtimin e sipërfaqeve të gjelbërta ndonse për nga sasia e m2, janë modeste.

ë) masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;

Për të shmangur dhe zbutur ndikimet negative në mjedis ka rëndësi në rradhë të parë zbatimi me përpikmëri dhe rigorozitet i projektit teknologjik për prerjen e blloqeve të mermerit dhe luçidimin e pllakave.

Në projektin teknologjik janë parashikuar jo vetëm proceset e punës, apo operacionet që do të bëhen për prerjen ellokut dhe kuçidimin e pllakave, por janë përcaktuar dhe masta për mbarvajtjen e projektit pa shkaktuar problemetë tjera duke filluar nga përhapja e zhurmave, përzierja e ujit, me grimcat e mermerit, pastrimi i tij, grumbullimi i grimcave të ngurat të mermerit, depozitimi i tyre deri në përdorim.

Të gjitha këto masa janë pjesë e procesit teknologjik, dhe shoqërojnë këtë proces në të gjithë hallkat e tij, duke filluar që nga transporti i blloqeve, i cili bëhet me mjete transporti të kolauduara, depozitimi i tyre para repartit teknologjik, lëvizja e blloqeveme karrel në shina nëpërmjet komandimit me plt, futja në makinerë prerëse, për të vazhduar me tej në rezenimin e pllakave të rera dhe luçidimin e tyre, procese të cilat kryehn të gjitha automatikisht, duke u komanduar nga pulete komandimi që ka secila makineri.

f) ndikimet e mundshme në mjedisin ndër-kufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

Aktiviteti i prerjes së blloqeve të mermerit dhe luçidimi i pllakave të memert, është aktivitet i cili zhvillohet në fshatin Kaçe, Bashkia Vau i Dejës, Qarku Shkodër, i cili ndodhet nëlargësi shumë të mëdha nga kufijtë me vendet e tjera si Mali i Zi, i cili është në drejtimin veri dhe verilindor me objekti, Kosovën ne veri të objektit apo Republikën e Maqedonisë së Veriut në lindje të objektit.

Ky aktivitet nuk ka ndikim brënda sipërfaqes ku zhvillohet, jasht perimetrin të objektit dhe aq më tepër që nuk ka ndikim ndër-kufitar.

HARTOI RAPORTIN:

STUDIO “INNOVATION DEVELOPMENT ENGINEERING” Shpk

Administratore dhe Inxhinierë Mjedisi

Bardhyl SHUSHKU

Gjeinxhinier

Denis STASA

Ekspert Mjedisi

Xhevair DERMISHI

Gjeinxhinier

Ermir DERMISHI

